



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3742/2 Prot.

Pogradec, më 18 08 .2021

VENDIM

NR 72, DATË 17 08 .2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC NR.108, DATË 21.10.2020 "PËR MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJE AMBJENTI DHE OBJEKTI ME QIRA, PËR TË SHËRBYER SI KOPSHTË"

Në mbështetje të; shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, shkronjës "b" dhe shkronjës "gj" të nenit 64 të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.108, datë 21.10.2020, "Për miratimin e normave, kriterëve, rregullave dhe procedurave për marrje ambient dhe objekti me qira, për të shërbyer si kopshte", i konfirmuar me shkresën Nr.963/1 Prot., datë 05.11.2020, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit", e protokolluar pranë bashkisë Pogradec me Nr.5096/7 Prot, datë 13.11.2020, si dhe mbështetur tek Relacionet shpjeguese të Qendrës Arsimore dhe Kërkesat e Administratorëve të Njësive Administrative përkatëse,

VENDOSI:

1. Të rinovohen kontratat e lidhura në vitin 2020 nga Bashkia Pogradec për ambjentet e marra me qera në kuadër të funksionimit të tyre si objekte që do të shërbejnë si kopshte.
2. Rinovimi i këtyre kontratave hyn në fuqi më datë 01.09.2021, që korespondon me fillim e Vitit të Ri shkollor 2021-2022 dhe të zgjasë deri më 01.07.2022.
3. Vlera e kontratave dhe Kushtet e tjera të tyre mbeten të pandryshuara, me përjashtim të fshatit Buzaishtë, të Njesisë Administrative Velçan, pasi me rritjen e numrit të nxënësve, kërkohet që krahas ambjentit për kopshte të krijohet një ambjent për çerdhe. Vlera e qerasë mujore për të dyja këto ambjente, të mos e kalojë vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë. Vlerat për secilën Njësi Administrative janë si më poshtë.



PËR AMBIENTET E MARRA ME QIRA PËR INSTITUCIONE ARSIMORE NË FSHATRA:

1. Fshati **Nizhavec** në *Njësinë Administrative Çërravë*. Ambienti shërben si kopësht bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 84, datë 23.10.2018.

Vlera e qerasë 6.500 lekë në muaj

2. Fshati **Selcë e Poshtme** në *Njësinë Administrative Proptisht*. Ambienti shërben si shkollë bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 3, datë 11.01.2016.

Vlera e qerasë 8.000 lekë në muaj

3. Fshati **Kalivaç** në *Njësinë Administrative Trebinjë*. Ambienti shërben si kopësht bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 82, datë 23.08.2019.

Vlera e qerasë 5.000 lekë në muaj

4. Fshati **Buzaishtë** në *Njësinë Administrative Velçan*. Do të merren dy ambiente që të shërbejnë si kopësht dhe si shkollë.

Vlera e qerasë 8.000 lekë në muaj

5. Fshati **Stropskë** në *Njësinë Administrative Dardhas*. Ambienti shërben si kopësht bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 58, datë 17.12.2015.

Vlera e qerasë 8.000 lekë në muaj

6. Fshati **Prenisht** në *Njësinë Administrative Dardhas*. Ambienti do të shërbejë si shkollë.

Vlera e qerasë 4.000 lekë në muaj

Mbështetur në Vendimet e sipërpërmendura të Këshillit të Bashkisë Pogradec do të lidhen kontratat për vitin e ri arsimor 2021-2022.

4.Për zbatimin e vendimit , ngarkohet Kryetari i Bashkisë , Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe e Prokurimeve Publike , Qendra Arsimore e Bashkisë si dhe administrata e bashkisë Pogradec.

5.Ky vendim hyn në fuqi ,10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

